

Kontrolli me rezonancë magnetike (MRI) gjatë shtatzënisë

AL

E nderuara paciente

Mjeku Juaj / mjekja Juaj u ka paraqitur Juve për kontroll magnetik me rezonancë (MRI). Me këtë letër informuese dëshirojmë t'u njoftojmë lidhur me aspektet e veçanta të kontrollit me rezonancë magnetike (MRI) gjatë shtatzënisë.

Kontrolli me rezonancë magnetike (MRI)

Studimet e deritanishme nuk kanë treguar ndonjë efekt të dëmshëm të shkaktuar nga kontrolli me rezonancë magnetike (MRI) ndaj foshnjës së palindur në zhvillim. Mirëpo, kjo nuk nënkupton automatikisht se për foshnjën e palindur nuk ka rrezik tjetër. Për këtë arsye, në rast shtatzënie duhet verifikuar me kujdes nëse kontrolli me rezonancë magnetike (MRI) është i domosdoshëm, përkatësisht i arsyeshëm kur ballafaqohemi me dilemën (sa është e dobishme dhe sa paraqet rrezik). Te pacientet shtatzënë kontrollat me rezonancë magnetike (MRI) mund të ndërmerren vetëm atëherë kur dobia nga ky kontroll është më e madhe se rreziku. Për këtë arsye, në tre muajt e parë të shtatzënisë nuk rekomandohen as shqyrtime speciale për kontroll me rezonancë magnetike (MRI), ndërsa një gjë e tillë mund të bëhet pas muajit të tretë të shtatzënisë. Shqyrtimi i mundësive të tjera duhet të pasqyrohet dhe të dokumentohet në raportin radiologjik.

- Problematika mjekësore nuk mund të sqarohet përmes një kontrolli me ultratingull.
- Diagnoza e kontrollit me rezonancë magnetike (MRI) mund të ndikojë në mjekimin e pacientes ose të fetusit gjatë shtatzënisë.
- Mjeku që jep udhëzimin nuk e sheh të arsyeshme që kontrolli me rezonancë magnetike (MRI) të zbatohet vetëm në fund të shtatzënisë.

Preparatet kontraste që përdoren për rezonancën magnetike (MRI)

Preparatet kontraste që përdoren për rezonancë magnetike (MRI), pacienteve shtatzënë nuk duhet t'u jepen në mënyrë rutine. Vendimi për përdorimin e preparatit kontrast që përdoret për rezonancë magnetike (MRI), në raste të veçanta duhet të merret pasi të konstatohet se dobia është më e madhe se rreziku.

Preparati kontrast që shfrytëzohet për rezonancë magnetike (MRI) duhet të përdoret vetëm atëherë kur kemi informata shtesë se përdorimi i tij është i domosdoshëm për pacienten apo për foshnjën e palindur. Po qe se dhënia e preparatit kontrast konsiderohet e domosdoshme, përkatësisht tejet e arsyeshme, atëherë pacientes shtatzënë duhet t'i jepet doza minimale, për arsye se preparatet kontraste që përmbajnë gadolin, mund ta shpojnë placentën. Pas kontrollit me rezonancë magnetike (MRI) nuk nevojiten teste prenatale (para lindjes). Te pacientet shtatzënë me funksion të kufizuar të veshkave nuk duhet të përdoren preparate kontraste që shfrytëzohen për rezonancë magnetike (MRI).

Referencat:

ACR Guidance Document on MR Safe Practices: 2013
ESUR Guidelines on Contrast Media Version 9.0

Mbiemri:	<input type="text"/>
Emri:	<input type="text"/>
Data e lindjes:	<input type="text"/>

Po qe se jeni dakord me zbatimin e kontrollit të parashikuar me rezonancë magnetike, Ju lusim që të nënshkruani më poshtë. **Kuptohet se Ju në çdo kohë mund të na parashtroni pyetje, qoftë para kontrollit, qoftë gjatë kontrollit.**

Data: Nënshkrimi i pacientes/pacientit: Radiologu: